



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-222

**PËR RATIFIKIMIN E NENEVE TË MARRËVESHJES THEMELUESE
TË BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS DHE
ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BZHKE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E NENEVE TË MARRËVESHJES
THEMELUESE TË BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË
EVROPËS DHE ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BZHKE**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka qëllim krijimin e kushteve ligjore për kryerjen e procedurave të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën për Zhvillim e Këshillit të Evropës.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i ligjit përfshin realizimin e procedurave administrative të nevojshme për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bankën për Zhvillim e Këshillit të Evropës.

Neni 3
Ratifikimi i Statutit të BZHKE-së

Ratifikohen Nenet e Marrëveshjes së Bankës për Zhvillim e Këshillit të Evropës, Nenet e reja të Marrëveshjes u miratuan më 16 qershor 1993, hynë në fuqi më 18 mars 1997, dhe janë ndryshuar më 17 dhjetor të vitit 1999, më 26 nëntor 2010 dhe më 25 dhjetor 2011 (Statuti i BZHKE-së).

Neni 4
Aprovim i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në BZHKE

Aprovohet anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Bankën Për Zhvillim e Këshillit të Evropës në përputhje me kushtet e specifikuar në Rezolutën 405(2013) të Bordit Drejtues të BZHKE-së.

Neni 5
Obligimet Republikës së Kosovës

1. Pas Ratifikimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës të Statutit të BZHKE-së obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë të gjitha masat që t'i përmbushë obligimet të cilat dalin nga marrëveshja e ratifikuar.
2. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i përmbushë gjitha kushtet dhe detyrimet financiare të cilat dalin nga Rezoluta nr. 405 (2013) e Bordit Drejtues të BZHKE-së në afatet e përcaktuara në këtë rezolutë.
3. Siç përcaktohet në Rezolutën e Bordit Drejtues dhe në përputhje me nenin III të Statutit të BZHKE-së dhe legjislacionit të brendshëm Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet të lidhë marrëveshje të veçantë me BZHKE-në për njohjen e imuniteteve dhe privilegjeve në përputhje me dispozitat e Protokollit të Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës.
4. Në pritje të finalizimit të marrëveshjes në fjalë Republika e Kosovës do të aplikojë këto privilegje dhe imunitetet ndaj organeve dhe stafit të BZHKE-së si dhe asetet, pronat dhe operacionet.

Neni 6
Përfaqësimi i Republikës së Kosovës në BZHKE

1. Qeveria e Republikës së Kosovës do të emërojë përfaqësuesin e Republikës së Kosovës në Bordin Drejtues të Bankës për Zhvillim e Këshillit të Evropës në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së ratifikuar.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës do të emërojë përfaqësuesin e Republikës së Kosovës në Këshillin Administrativ të Bankës për Zhvillim e Këshillit të Evropës në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së ratifikuar.

Neni 7
Shtesa të marrëveshjes

1. Aneksi 1, përmban nenet e Marrëveshjes së Bankës për Zhvillim e Këshillit të Evropës, të miratuar më 16 qershor 1993 dhe hyrë në fuqi më 18 mars 1997, me ndryshimet e bëra më 17 dhjetor 1999, në 26 nëntor 2010 dhe 25 dhjetor 2011 (Statuti i BZHKE-së).
2. Aneksi 2, përmban Rezolutën nr. 405 (2013) të miratuar nga Bordi Drejtues i *Bankës për Zhvillim e Këshillit të Evropës* me datë 14 qershor 2013.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-222
02 tetor 2013

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI



BANKA PËR ZHVILLIM E KËSHILLIT TË EVROPËS

NENET E MARRËVESHJES

Botim i përditësuar në Nëntor 2011

Neni 1

Themelimi i Bankës

Themelohet një Bankë për Zhvillim e Këshillit të Evropës (më tutje "Banka"). Banka është e lidhur për Këshillin e Evropës dhe administrohet nga autoriteti i vet më i lartë.

Neni II¹

Qëllimi

a. Qëllimi parësor i Bankës është për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve sociale me të cilat ballafaqohen ose mund ballafaqohen vendet Evropiane si rezultat i pranisë së refugjatëve, personave të zhvendosur ose emigruesve si rrjedhojë e lëvizjes së refugjatëve dhe apo të lëvizjeve të tjera me forcë të popullatës dhe si rezultat i pranisë së viktimave nga katastrofat natyrore ose ekologjike.

Projektet investuese në të cilat kontribuon Banka mund të qenë për qëllim qoftë të ndihmojnë qytetarët e tillë në shtetin në të cilin gjenden ose t'u mundësohet të kthehen në vendet e tyre të origjinës kur të jenë përmbushur kushtet për kthimin e tyre, ose, kur është e zbatueshme, që të vendosen në një shtet tjetër nikoqir. Këto projekte duhet të miratohen nga një anëtar i Bankës.

b. Banka po ashtu mund të kontribuojë në realizimin e projekteve investuese të miratuara nga një Anëtar i Bankës që mundëson krijimin e vendeve të punës në rajoneve a pa favorizuara, strehimi i personave që bëjnë pjesë në grupet me të ardhura të ulëta ose krijimi i infrastrukturës sociale.

Neni III

Anëtarësia në Bankë

a. Cilido shtet anëtarë në Këshillin e Evropës mund të bëhet anëtarë në Bankë duke i adresuar një deklaratë Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo deklaratë përmban pranimin e neneve ekzistuese të Marrëveshjes nga ana e Qeverisë së Shtetit në fjalë dhe nënshkrimin nga ajo Qeveri për numrin e certifikatave pjesëmarrëse të parashtruara në marrëveshje me Bordin Qeverisës, në përputhje me Nenin IX, Seksioni 3, paragrafi 1. *litt.* a. të neneve të Marrëveshjes.

b. Një shtet Evropian që nuk është anëtar i Këshillit të Evropës mundet:

i. të pranohet si anëtar i Bankës sipas kushteve speciale siç përcaktohet nga Banka për secilin rast, në përputhje me dispozitat e Nenin IX, Seksioni 3, paragrafi 1, *litt.* Shteti për të cilin është marrë një vendim i tillë për pranim, është në gjendje të bëhet anëtar i Bankës duke depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës një instrument që deklaron se pranon nenet ekzistuese të Marrëveshjes, nënshkruan me Bordin Qeverisës numrin e certifikatave pjesëmarrëse të parashtruara në marrëveshje, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për t'ia mundësuar që të përmbushë të gjitha obligimet që burojnë nga nenet e Marrëveshjes dhe ka përmbushur të gjitha kushtet e pranimin të përcaktuara nga Bordi Qeverisës;

ii. ose arritja e një marrëveshje asociimi me Bankës mbi kushte të tilla të veçanta siç mund t'i përcaktojë Banka në secilin rast.

c. Me përcaktimin e kushteve të përcaktuara nga Bordi Qeverisës, institucionet ndërkombëtare me fokus Evropian mund të bëhen po ashtu Anëtare të Bankës ose të arrijnë një marrëveshje asociimi.

¹ Teksti i këtij neni është miratuar nga Komiteti i Ministrave në takimin e 495-të të Zëvendësve të Ministrave përmes Rezolutës (93)22 të bashkangjitur si shtojcë.

d. Cilido shtet që bëhet anëtar i Bankës konfirmon qëllimet e veta në deklaratën apo instrumentin e vet të pranimit të neneve të Marrëveshjes:

- i. të pranojë në mundësinë më të hershme Protokollin e Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës;
- ii. deri në pranimin e kësaj, zbaton aranzhimet ligjore që rezultojnë nga Protokollin për pronën, asetet dhe veprimet e Bankës dhe të organeve dhe stafit të Bankës t'u sigurojë statusin juridik që rezultojnë nga Protokollin.

Neni IV

Obligimet e Anëtarëve

Seksioni 1 - *Certifikatat Pjesëmarrëse*

Banka lëshon certifikata pjesëmarrëse për t'u nënshkruar nga anëtarët e saj dhe të cilat shprehen në termet e euros (EUR). Secila certifikatë mban vlerën e njëjtë nominale prej 1,000 EUR. Anëtarët paguajnë nënshkrimet e tyre në Euro.

Seksioni 2 - *Shpërndarja dhe pagesa për certifikatat pjesëmarrëse*

- a. Tabelat si shtojcë ndaj neneve ekzistuese të Marrëveshjes përcaktojnë shpërndarjen në përqindje për certifikatat pjesëmarrëse që janë siguruar për abonim nga secili anëtar i Bankës.
- b. numri i certifikatave pjesëmarrëse që mbahen nga anëtarët e rinj të Bankës përcaktohen në marrëveshje me Bordin Qeverisës të Bankës, në përputhje me Kreun IX, Neni 3, paragrafi 1. *litt.* a dhe b. të Neneve të Marrëveshjes ekzistuese.
- c. Përqindja ekzistuese e certifikatave pjesëmarrëse që duhet të paguhet, si dhe datat e pagesave relevante përcaktohen nga Bordi Qeverisës.
- d. Kur rritet kapitali i Bankës, Bordi Qeverisës, bazuar në kushtet uniforme për të gjithë anëtarët, përcakton përqindjen që duhet të paguhet dhe datat korresponduese për pagesa.

Neni 3 - *Kufizimi i përgjegjësisë*

Asnjë anëtar nuk mban përgjegjësi ndaj palëve të treta për çfarëdo obligimi të Bankës.

Neni V

Veprimet huamarrëse dhe kontributet

Banka mund të marrë hua për përdorime që janë konsistente me qëllimin e saj. Banka po ashtu mund të realizojë çfarëdo transaksioni tjetër financiar që shërben për arritjen e qëllimit të vet në përputhje me kushtet e parashtruara nga Këshilli Administrativ.

Banka ka autoritetin të pranojë kontribute që i ofrohen qëllimeve specifike që cilat hyjnë brenda synimeve të saj të deklaruara.

Neni VI

Investimet

Asetet likuide të Bankës, kapitali dhe rezervat mund të investohen sipas kushteve që përcaktohen nga Këshilli Administrativ në përputhje me parimet e shëndosha të menaxhimit financiar.

Neni VII

Mjetet e Bankës për Veprim

Seksioni 1 - Kreditë

Kreditë e krijuara nga Banka do të jenë në një nga format në vijim:

- a. kredi për anëtarët e Bankës
- b. kredi të garantuara nga një anëtar i Bankës, e dhënë për cilindo person juridik të miratuar nga ky anëtar;
- c. kreditë e dhëna cilitdo personi juridik të miratuar nga një anëtar i Bankës, kur Këshilli Administrativ është i kënaqur se kredia e kërkuar është e mbuluar nga garancitë adekuate.

Seksioni 2 - Garancitë

Sipas kushteve që përcaktohen nga Këshilli Administrativ për secilin rast, Banka mund të lëshojë garancinë e vet për institucionet financiare të miratuara nga një Anëtar për kredi që shërbejnë për realizimin e mëtejme të qëllimeve të cekura në Nenin II.

Seksioni 3 - Certifikatat Pjesëmarrëse

Banka mund të hapë dhe menaxhojë llogaritë e trustit për të pranuar kontribute vullnetare nga anëtarët e vetë, nga Banka dhe nga Këshilli i Evropës.

Seksioni 4 - Zbritje Interesi

Kreditë mund të shoqërohen me zbritje të plotë ose të pjesshme të interesit.

Një pjesë e fitimeve të realizuara nga Banka dhe kontributet vullnetare nga Anëtarët do të përdoren për të subvencionuar normën e interesit mbi kushtet e kredive të caktuara të vendosura nga Këshilli Administrativ.

Seksioni 5 - Kushtet për dhënien e kredive - Informacioni që duhet të ofrohet

Këshilli Administrativ përcakton kushtet e përgjithshme për dhënien e kredive dhe përcakton se çfarë informacioni duhet të sigurojë huamarrësi kur dorëzon kërkesën.

Seksioni 6 - Mos kryerja e pagesës

Transaksioni i Bankës drejt një anëtari ose personi juridik të referuar në Seksionin 1 si më lartë, pezullohet në qoftë se huamarrësi, ose nëse ky i fundit dështon, garantuesi nuk realizon pagesat sipas afatit sa i përket kredive ose garancive të dhëna nga Banka.

Neni VIII

Organizimi, administrimi dhe mbikëqyrja e Bankës

Organizimi, administrimi dhe mbikëqyrja e Bankës ndahet si në vijim:

- Bordi qeverisës
- Këshilli Administrativ
- Guvernatori
- Bordi i Auditimit

siç parashtrohet në Nenet në vijim:

Neni IX

Bordi Qeverisës

Seksioni 1

Bordi Qeverisës përbëhet nga Kryesuesi dhe një përfaqësues i emëruar nga secili Anëtar. Secili anëtarë mund të caktojë një zëvendësues. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës mund të marrë pjesë ose të përfaqësohet në takime.

Seksioni 2

Bordi Qeverisës është organi suprem i Bankës; ky vishet me të gjitha pushtetet sa i përket Bankës, ruan të drejtën të ndryshojë qëllimet e veta siç parashtrohet në Nenin II të Neneve të Marrëveshjes.

Seksioni 3

1. Bordi Qeverisës

- a. përcakton kushtet përmes së cilave shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës bëhen Anëtarë të Bankës
- b. autorizon shtetet Evropiane që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës dhe institucioneve ndërkombëtare me fokus Evropian që të bëhen anëtare të Bankës dhe të parashtrorjnë kushtet për një autorizim të tillë si dhe numrin e certifikatave pjesëmarrëse për t'u nënshkruar nga këta anëtarë;
- c. përshtat ndarjen e kapitalit ndërmjet Anëtarëve siç paraqitet në tabelën e bashkangjitur në Neneve të Marrëveshjes ekzistuese.
- d. rritja ose zvogëlimi i kapitalit të autorizuar dhe përcaktimi i përpjesëtimit të aksioneve të nënshkruara që duhet të paguhet dhe datat deri kur duhet të realizohet pagesa;
- e. sigurimi i zbatueshmërisë me synimet e cekura në Nenet e Marrëveshjes; miratimi i raportit të Bankës, llogarive dhe deklaratave të tjera financiare; sigurimi i udhëzimeve të përgjithshme lidhur me aktivitetin e institucionit;
- f. pezullimi ose ndërprerja e veprimeve të Bankës dhe, në rast të likuidimit, shpërndarja e aseteve të saj;
- g. pezullimi i anëtarit;
- h. ndryshimi i këtyre Neneve të Marrëveshjes, por pa bërë ndryshime në synimeve që deklarohen aty.
- i. interpreton këto Nene të Marrëveshjes dhe vendos çfarëdo ankimi kundër vendimeve që ndërliidhen me interpretimin e zbatimit të Neneve të Marrëveshjes;
- j. autorizon konkluzat e marrëveshjeve të përgjithshme mbi bashkëpunimin me organizatat e tjera ndërkombëtare;
- k. përzgjedhë Kryesuesin e Bordit Qeverisës dhe Kryesuesit të Këshillit Administrativ;
- l. cakton Guvernatorin, dhe sipas nevojës, me propozimin e Guvernatorit, një ose më shumë zëvendës Guvernatorë, njëri nga të cilët zëvendëson Guvernatorin kur ky i fundit mungon, si dhe i

CEB - Nenet e Marrëveshjes

shkarkon ata nga postet e tyre dhe pranon dorëheqjen e tyre;

- m. cakton anëtarët e Bordit të Auditimit;
- n. cakton auditorin e jashtëm dhe parashtron termat e tij të referencës
- o. harton Rregulloren e Punës
- p. ushtron pushtete të tjera të atilla siç i caktohen shprehimisht Bordit Qeverisës në këto NENE TË MARRËVESHJES

2. Bordi Qeverisës merr vendimet lidhur me *litt. d.* dhe *f.* mbi propozimin e Këshillit Administrativ, dhe *litt. c.*, *n.* dhe *n.*, pasi ky i fundit të jetë dëgjuar. Këshilli Administrativ jep mendimin e vet mbi të gjitha vendimet e tjera me pasoja financiare.

3. Të gjitha pushtetet përpos atyre të parashtruara në Seksionin 3, paragrafi 1 më lartë delegohen tek Këshilli Administrativ.

Pushtetet e deleguara tek Këshilli Administrativ në këto Nene të Marrëveshjes mund të rimerren vetëm në rrethana të veçanta dhe për periudha të caktuara kohore.

4. Bordi Qeverisës takohet një herë në vit. Sipas nevojës, mund të mbajë edhe takime shtesë.

5. Kur të jetë e nevojshme, Bordi Qeverisës mund të ftojë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare ose persona të tjerë të interesuar që të marrin pjesë në seancat e veta por pa të drejtë vote.

Seksioni 4

a. Vendimet që merren nga Bordi Qeverisës në takimet e veta janë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm dy të tretat (2/3) e përfaqësuesve të anëtarëve.

Vendimet merren me votim. Me qëllim të llogaritjes së shumicave, të vlefshme do të jenë vetëm votat pro dhe kundër.

b. Vendimet mund të merren edhe me shkrim ndërmjet takimeve.

c. Secili anëtar i Bankës do të ketë një votë për secilën certifikatë pjesëmarrëse që mban.

d. Cilido anëtar që nuk ka paguar pjesën e vet të kapitalit brenda afatit nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës përderisa mospagesat e tilla vijojnë dhe përderisa shumë përkatëse të mos paguhet.

e. Vendimet arrihen me shumicën e anëtarëve që votojnë pro ose kundër dhe që përbejnë dy të tretat (2/3) e votave të hedhura.

f. Kërkohej shumica prej tre të katërtave të Anëtarëve që votojnë në pro ose kundër dhe që mbajnë tre çerekun e votave të hedhura për:

- vendimin siç parashtrohet në Seksionin 3, paragrafi 3. i këtij Neni;
- përshtatjen e tabelës së përpjesëtimit që gjenden në Aneks të këtyre Neneve të Marrëveshjes që nuk rezultojnë nga pranimi i Anëtarëve të rinj realizohen sipas Seksionit 3, paragrafi 1. *litt. c.*

g. Vendimet e referuara në Seksionin 3, paragrafi 1. *litt. f.* dhe *h.*, merren me votë unanime të anëtarëve që votojnë.

Seksioni 5

a. Bordi qeverisës drejtohet nga një Kryesues që zgjidhet nga ky për një mandat tre vjeçar.

Kryesuesi në largim mund të ri-zgjidhet për një mandat tjetër tre-vjeçar. Secili Anëtar i Bankës gëzon të drejtën të paraqesë një kandidat.

Në bashkëpunim të ngushtë me Guvernatorin, Kryesuesi është përgjegjës për marrëdhëniet politike me zyrtarët e Shteteve, Këshillin e Evropës dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

Kryesuesi informon rregullisht Komitetin e Ministrave dhe Asamblenë Parlamentare mbi aktivitetet e Bankës; ndër të tjera, ai përcjellë raportin e Guvernatorit tek Komiteti i Ministrave dhe ruan të gjitha kontaktet e nevojshme me Këshillin e Evropës.

Neni X
Këshilli Administrativ

Seksioni 1
Këshilli Administrativ ka të gjitha autoritetin që i delegohet nga Bordi Qeverisës në përputhje me Nenin IX.

Seksioni 2

a. Këshilli Administrativ përbëhet nga Kryesuesi që caktohet nga Bordi Qeverisës për një mandat 3 vjeçar, që mund të ripërtërihet me një mandat shtesë tre vjeçar, dhe një përfaqësues i caktuar nga secili anëtar. Secili Anëtar mund të caktojë një anëtar. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës mund të marrë pjesë ose të përfaqësohet në takime.

b. Këshilli Administrativ thirret nga Kryesuesi ose me kërkesë të pesë anëtarëve të vet dhe mbledhet së paku katër herë në vit.

c. Kur të jetë e nevojshme, Këshilli Administrativ mund të ftojë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare ose persona të tjerë të interesuar që të marrin pjesë në seancat e veta por pa të drejtë vote.

Seksioni 3

a. Vendimet e Këshillit Administrativ në takimet e veta janë valide vetëm nëse janë të pranishëm dy të tretat e përfaqësuesve të Anëtarëve.

b. Secili anëtar do të ketë një votë për secilën certifikatë pjesëmarrjeve që zotëron.

Vendimet merren me shumicë votash. Vetëm votat pro dhe kundër merren parasysh me qëllim që të llogaritet së shumicës ose shumicave.

c. Vendimet mund të merren edhe ndërmjet takimeve në formë të shkruar.

d. Cilido anëtar që nuk ka paguar pjesën e vet të kapitalit brenda afatit nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës përderisa mospagesat e tilla vijojnë dhe përderisa shumë përkatëse të mos paguhet

e. Sidoqoftë, Këshilli Administrativ miraton vendimet si në vijim me shumicë të anëtarëve që votojnë për ose kundër dhe më shumicën e votave të hedhura:

i) propozimet dhe opinionet e adresuara tek Bordi Qeverisës në përputhje me Nenin IX, Seksioni 3, paragrafi 1 *lett. C., d., f., m. Dhe n.;*

ii) miratimi ose ndryshimi i Rregullores së Punës së Këshillit Administrativ.

f. Për më tepër, Këshilli Administrativ, me shumicën e Anëtarëve që votojnë për ose kundër, dhe që mbajnë dy të tretat e votave të hedhura, vendos lidhur me projektet investuese që nuk kanë marrë mendimin për pranueshmërinë siç referohet në Nenin XIII, *litt. C*. Të Neneve të Marrëveshjes.

Seksioni 4

Në çfarëdo kohë, Këshilli Administrativ mund të caktojë komisione nga radhët e anëtarëve dhe këtyre komisioneve t'u delegojë pushtetet që specifikohen në secilin rast.

Neni XI

Guvernatori

Seksioni 1 – *Funksionet e Guvernatorit*

- a. Guvernatori është përfaqësuesi ligjor i Bankës. Ai është drejtuesi i shërbimeve operative të Bankës dhe drejton aktivitetin afarist të përditshëm sipas udhëzimeve të Këshillit Administrativ. Sipas Neneve V dhe VII ai nuk kontraktton asnjë detyrim financiar pa autorizimin e Këshillit Administrativ. Ai, duke qenë nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Këshillit Administrativ, është përgjegjës për organizimin e shërbimeve operative si dhe për emërimet dhe shkarkimet e punonjësve të Bankës, brenda kornizës së rregulloreve të adoptuara nga Këshilli Administrativ.
- b. Guvernatori emërohet për një periudhë pesë vjeçare, e përsëritshme vetëm një herë. Rroga e tij do të përcaktohet nga Këshilli Administrativ.
- c. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, Guvernatori, zëvendës Guvernatori dhe punonjësit duhet t'i përkushtohen plotësisht shërbimit ndaj Bankës, duke përjashtuar çfarëdo aktiviteti tjetër. Secili Anëtar respekton karakterin ndërkombëtar të detyrës së Guvernatorit, zëvendës Guvernatorëve dhe punonjësve të Bankës dhe përmbahet nga çfarëdo përpjekje për të ndikuar mbi këta persona.
- d. Rregulloret e Punonjësve të Këshillit të Evropës janë të zbatueshme mbi punonjësit e Bankës për cilëndo çështje që nuk është e mbuluar me vendim specifik të Këshillit Administrativ.

Seksioni 2 – *zëvendës Guvernatorët*

- a. Guvernatori asistohet nga dy ose më shumë zëvendës Guvernatorë. Guvernatori përcakton një zëvendës Guvernator të deleguar, cili do ta zëvendësojë në rast mungese ose pamundësie. Guvernatori përcakton detyrat e zëvendës Guvernatorëve, duke marrë parasysh përshkrimet e postit zyrtar të aprovuara nga këshilli Administrativ.
- b. Zëvendës Guvernatorët emërohen nga Bordi Qeverisës me propozim të Guvernatorit, pas dhënies së opinionit mbi përputhshmërinë nga Këshilli Administrativ dhe pas konsultimeve me anëtarët e Bordit Qeverisës.
- c. Me propozim të Guvernatorit, Këshilli administrativ aprovon përshkrimet e posteve zyrtare të zëvendës Guvernatorëve.
- d. Zëvendës Guvernatori emërohet për një periudhë pesë vjeçare, e përsëritshme vetëm një herë. Rroga e tyre përcaktohet nga Këshilli Administrativ.

Seksioni 3 – *Raportet për Këshillin Administrativ*

Guvernatori jep opinionin e tij tek Këshilli Administrativ mbi aspekte teknike dhe financiare të projekteve të investimit të dorëzuara në Bankë.

Guvernatori i dorëzon Këshillit Administrativ raporte të rregullta mbi pozicionin e Bankës dhe mbi transaksionet e propozuara, si edhe çfarëdo informacioni që mund t'i kërkohet.

Guvernatori përgatit raportin e plotë vjetor mbi të gjitha operacionet e kryera gjatë vitit. Ky raport shoqërohet nga bilanci i Bankës dhe llogaritë operative, së bashku me raportin e Bordit të Auditimit mbi këto dokumente.

Neni XII

Bordi i Auditimit

Bordi i Auditimit përbëhet nga tre anëtarë, në përputhje me Nenin IX, Seksioni 3, *germa m*. Në lidhje me kompetencën e tyre në çështje ekonomike dhe financiare. Ata do të veprojnë krejtësisht të pavarur.

Bordi i Auditimit inspekton llogaritë e Bankës dhe verifikon a janë në rregull llogaritë operative dhe bilanci.

Në raportin e tij vjetor, Bordi i Auditimit duhet të certifikojë se bilanci dhe llogaritë operative qëndrojnë sipas regjistrave, se ata japin një pasqyrë të saktë dhe të vërtetë të gjendjes së punëve të bankës në fund të çdo periudhe financiare dhe se banka është duke u menaxhuar në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Bordi merr kopje të çdo dokumenti të dobishme për atë në punën e tij, të tilla si raportet e auditorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Me kërkesë të organeve të Bankës, Bordi kryen çdo detyrë tjetër që ka të bëjë me mbikëqyrjen e aktivitetit financiar të Bankës.

Neni XIII

Këshilli i Evropës

- a. Me synimin për të siguruar marrëdhëniet me Këshillin e Evropës, informohet rregullisht Komiteti i Ministrave dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për aktivitetet e Bankës. Bordi Drejtues deklaron pozicionin e tij mbi rekomandimet dhe opinionet e dhëna nga Komiteti i Ministrave dhe Asambleja Parlamentare.
- b. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës merr pjesë, ose mund të përfaqësohet në mbledhjet e Bordit Qeverisës dhe Këshillit Administrativ, pa të drejtë vote.

Ai kryen çdo detyrë që i është besuar atij në zbatim të Neneve të Marrëveshjes aktuale apo të Protokollit të Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës. Në lidhje me këtë ai do të vendosë punonjësit e nevojshëm në dispozicion të Bankës.

Ai mund të kryejë çdo detyrë tjetër besuar atij nga organet e Bankës, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Pjesëshe për Këshillin e Bankës Evropiane për Zhvillim.

- c. Aplikimet për hua ose garanci duhet të dorëzohet në Këshillin Administrativ, pas marrjes së opinionit të Sekretarit të Përgjithshëm për pranueshmërinë bazuar në përputhshmërinë e projektit me synimet politike dhe sociale të Këshillit të Evropës.

Neni XIV

Selia Qendrore

Zyra kryesore e Bankës është në Strasburg, Francë. Selia e shërbimeve operative është në Paris dhe mund të ndryshohet vetëm me vendim të Bordit Qeverisës dhe një vendim të Këshillit Administrativ të formuluar me fjalë identike.

Neni XV

Pezullimi i operacioneve dhe likuidimi i Bankës

Seksioni 1 – Tërheqja e Anëtarëve

Çdo anëtar mund të tërhiqet nga Banka duke njoftuar për largimin e vet gjashtë muaj para përfundimit të vitit kalendarik në vazhdim. Dorëheqja merr efekt më 31 dhjetorin që e pason njoftimin. Asnjë njoftim i dhënë më pak se gjashtë muaj para fundit të vitit kalendarik merr efekt me 31 dhjetorin e vitit pasues. Anëtari mundet ta njoftojë Bankën me shkrim mbi anulimin e njoftimit të qëllimit për të dhënë dorëheqje në çfarëdo kohe para se dorëheqja të jetë efektive.

Seksioni 2 – Zgjidhja e llogarive me ish Anëtarë

- a. Pas datës në të cilën një Anëtar nuk është më Anëtar, ky Anëtar në fjalë do të jetë përgjegjës për detyrimet ndaj Bankës për sa kohë që nuk janë paguar një pjesë e huave ose garancive të lëshuara para se të ndërpriste Anëtarësinë; por nuk ka për të pasur më përgjegjësi të tilla ndaj huave dhe garancive që do të jepen paskëta nga Banka, as nuk do të ketë pjesë në të ardhurat ose shpenzimet e Bankës.
- b. Pas kohës në të cilën një Anëtar nuk është më Anëtar, Banka kujdeset për riblerjen e certifikatave të pjesëmarrjes të Anëtarit në fjalë, si pjesë e zgjidhjes së llogarive me ish Anëtarin në fjalë sipas dispozitave të këtij neni. Për këtë qëllim, çmimi i blerjes së certifikatave do t'i korrespondojë kapitalit të paguar plus rezervave, siç paraqitet në regjistrat e Bankës ditën e ndërprerjes së anëtarësisë.
- c. Pagesa për certifikatat e pjesëmarrjes të ri-blera nga Banka sipas këtij Neni do të varen nga kushtet e mëposhtme:
 - i. çfarëdo shume që është detyrim ndaj ish Anëtarit për certifikatat e veta nuk lëshohet për sa kohë që ish Anëtari dhe cilado nga agjencitë ose instrumentet e tyre kanë obligime, si huamarrës ose garantues, ndaj Bankës dhe, shuma në fjalë, duke u maturuar mundet të përdoret, sipas zgjedhjes së Bankës, për të shlyer këto obligime. Në asnjë rast nuk do të paguhet asnjë shumë e detyrimit ndaj Anëtarit për certifikatat pa kaluar gjashtë (6) muaj nga data që Anëtari nuk është më Anëtar;
 - ii. pagesat për certifikatat mund të kryhen kohë pas kohe, derisa ish Anëtari të ketë marrë të gjithë çmimin e ri-bletjes, deri në masën me të cilën shuma e detyrimit si çmim i ri-bletjes, sipas paragrafit b të këtij seksioni, tejkalon shumën agregate të detyrimeve mbi hua dhe garanci sipas përcaktimit të nën paragrafit (i) këtu më lart;
 - iii. pagesat do të kryhen në euro, sipas kushteve dhe datave të përcaktuara nga Bordi i Qeverisjes; dhe
 - iv. nëse Banka pëson humbje në cilëndo hua ose garanci të pashlyer në datën në të cilën tërheqja e Shtetit Anëtar hyn në fuqi dhe, nëse shuma e këtyre humbjeve është më e lartë se shuma, në atë datë, e provizioneve kundër humbjeve në datën kur tërheqja e Shtetit Anëtar hyn në fuqi, ky ish Anëtar në fjalë do të ri-paguajë, sipas kërkesës, sasinë me të cilën do të ishte ulur çmimi i ri-bletjes së certifikatave të veta nëse humbjet do të ishin marrë parasysh kur u përcaktua çmimi i ri-bletjes.

CEB - Nenet e Marrëveshjes

d. Nëse Banka i përfundon operacionet e veta sipas Seksionit 4 të këtij Neni brenda gjashtë (6) muajsh nga data në të cilën cilido Anëtar nuk është më Anëtar, të gjitha të drejtat e këtyre ish Anëtarëve përcaktohen sipas dispozitave të këtij seksioni.

Seksioni 3 – *Pezullimi i Operacioneve*

Nëse Bordi Qeverisës vendos të pezullojë aktivitetet, Banka do të ndërpresë të gjitha operacionet e huave dhe garancive.

Seksioni 4 – *Likuidimi i Bankës*

Nëse Bordi Qeverisës duhet të vendosë për përfundimin e operacioneve, Banka pushon menjëherë të gjitha aktivitetet përveç atyre incidentale për shlyerjen e detyrimeve të saj dhe, realizimin, konservimin dhe ruajtjen e aseteve të saj.

Pasi të jenë shlyer ose plotësuar të gjitha detyrimet e Bankës, duke përfshirë edhe plotësimin e të drejtave mbi shpërndarjen të cilat mund të jenë dhënë më parë nga Banka gjatë pranimit të kontributeve sipas Nenit V, Anëtarët e Bankës do të miratojnë një plan për shpërndarjen e aseteve, i cila do të bazohet në parimet e mëposhtme:

- a. Asnjë anëtar i Bankës kundër të cilit Banka ka një pretendim të paplotësuar, nuk do të ketë të drejtë për të marrë pjesë në shpërndarje sipas planit, derisa ta ketë rregulluar pozicionin e vet;
- b. Do t'u jepet prioritet përdorimit të aseteve neto të bankës për të rimbursuar Anëtarët për shumat e paguara nga ana e tyre në zbatim të nenit IV, në përpjesëtim me numrin e certifikatave paguara. Çdo tepricë mbi asetet neto të Bankës ndaj totalit agregat të e aksioneve të tilla të shpërndara do të ndahet mes të gjithë anëtarëve të Bankës në proporcion me numrin e certifikatave pjesëmarrëse të mbajtura nga secili;
- c. Nëse ka detyrime neto, ato do të shpërndahen në mesin e anëtarëve të Bankës në proporcion me numrin e certifikatave pjesëmarrëse të mbajtura nga secili. Çdo anëtar do të kërkohet të paguajë pjesën e vet për Bankën, duke zbritur certifikatat e paguara dhe në vlerën maksimale të certifikatave të nënshkruara.

Neni XVI

Interpretimi i këtyre Neneve të Marrëveshjes

Çdo vendim i Këshillit Administrativ që kërkon interpretimin e neneve të kësaj Marrëveshje mund të referohet tek Bordi Qeverisës me kërkesë të çdo Anëtari. Deri në kohën kur Bordi Qeverisës të marrë një vendim, Banka mund të veprojë në bazë të vendimit të Këshillit Administrativ, për aq sa e gjykon të nevojshme.

Neni XVII

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton Anëtarët e Bankës dhe Guvernatorin mbi:

CEB - Nenet e Marrëveshjes

- a. depozitim e çdo deklaratë apo instrumenti të pranimit të këtyre Neneve të Marrëveshjes;
- b. çdo dokument që ndryshon këto Nene të Marrëveshjes.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës dërgon nga një kopje të vërtetuar të këtyre Neneve të Marrëveshjes për secilin Shtet Anëtar të Këshillit të Evropës dhe çdo anëtar tjetër të Bankës.

CEB - Nenet e Marrëveshjes
SHTOJCË

TABELA E BASHKANGJITUR E NENEVE TË MARRËVESHJES QË TREGON NDARJEN NË PËRQINDJE NË MESIN E ANËTARËVE TË BANKËS ME CERTIFIKATA PJESËMARRËSE TË NËNSHKRUARA

(me ndryshimet që pasqyrojnë anëtarësimin e Bullgarisë (28.05.94), Sllovenisë (1.02.94), Lituaniës (8.01.96), Rumanisë (5.03.96), Kroacisë (24.06.97), "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë(15.12.97), Hungarisë (10.03.98), Estonia (1.04.98), Moldavisë (4.05.98), Polonisë (17.08.98), Letonisë (14.09.98), Sllovakisë (22.12.98), Republikës Çeke (12.02.99), Shqipërisë (24.06.99), Bosnjë Hercegovinës (18.12.2003), Serbisë (23.04.2004), Irlandës (30.11.2004), Gjeorgjisë (10.01.2007) dhe Malit të Zi (19.11.2007)

SHTETET ANËTARE	%	SHTETET ANËTARE	%
SHQIPËRIA	0,243	MALTA	0,184
BELGIKA	2,986	MOLDAVIA	0,100
BOSNIA DHE HERCEGOVINA	0,176	MALI I ZI	0,120
BULLGARIA	1,135	HOLANDA	3,613
KROACIA	0,388	NORVEGJIA	1,268
QIPRO	0,361	POLONIA	2,331
REPUBLIKA ÇEKE	0,782	PORTUGALIA	2,529
DANIMARKA	1,629	ROMANIA	1,089
ESTONIA	0,231	SAN-MARINO	0,088
FINLANDA	1,268	SERBIA	0,470
FRANCA	16,640	SLLOVAKIA	0,344
GJEORGJIA	0,179	SLLOVENIA	0,223
GJERMANIA	16,640	SPANJA	10,852
GREQIA	2,986	SUEDIA	2,529
VATIKANI	0,002	ZVICRA	1,629
HUNGARIA	0,814	ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË	0,231
ISLANDA	0,184	TURQIA	7,056
IRLANDA	0,878		
ITALIA	16,640		
LETONIA	0,233		
LIHTENSTAJNI	0,088		
LITUANIA	0,229		
LUKSEMBURGU	0,631		
		TOTAL	100,00

Rezoluta 405 (2013)

St. Julian (Malta) 14 Qershor 2013

CD/PV/205/2013

Bordi Drejtues,

Duke pasur parasysh aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës;

Duke potencuar që anëtarësimi i Kosovës në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës bëhet pa paragjykim ndaj qëndrimeve individuale të shteteve anëtare të BZHKE-së ndaj statusit të Kosovës;

Duke pasur parasysh nenet, III, IV, IX, seksionin 3, par. 1b dhe 2 të Neneve të Marrëveshjes së BZHKE;

Duke pasur parasysh Rezolutën 1557 (2013) të Këshillit Administrativ

Vendos

Të autorizojë Kosovën që të anëtarësohet në BZHKE në pajtim me kushtet si më poshtë:

- të zotohet se pranon certifikatat e participimit në vlerë 6 559 000 Euro, që korrespondojnë me vlerën e participimit të kapitalit të caktuar prej 0.12 %
- të paguaj shumën prej 728 000 Euro të kapitalit të përcaktuar ;
- Të paguaj shumën prej 2138 000 si kontribut në rezerva ;
- Të kryej këto pagesa në katër këste vjetore, kësti i parë i të cilës duhet të bëhet jo më vonë se 30 ditë nga anëtarësimi.

Këto kushte do të jenë të vlefshme për një vit në mënyrë që të kompletohen procedurat e anëtarësimit.

E fton Kosovën që të pranojë Nenet e Marrëveshjes së BZHKE-së.

E fton Kosovën që të konfirmojë në instrumentin e pranimit të Neneve të Marrëveshjes :

1. që pranon të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me BZHKE-në me të cilën i njeh të gjitha privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në dispozitat e Protokollit të Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Imunitetet dhe Privilegjet të Këshillit të Evropës.
2. Në pritje të finalizimit të marrëveshjes në fjalë ti zbatojë këto privilegje dhe imunitete ndaj organeve dhe stafit të BZHKE-së, aseteve, pronave dhe operacioneve.

Projekt Rezoluta e paraqitur nga Gjermania dhe Franca sipas pikës 6

Rezultati i votave

Numri i shteteve pjesëmarrëse	39
Votat e mbajtura nga këto shtete	5 403 201
Numri i shteteve për votimin PO	31
Numri i votave PO	4 681 207
Përqindja e votave të hedhura	87,670%
Numri i shteteve për votimin JO	5
Numri i votave JO	658 344
Përqindja e votave të hedhura	12,330%
Informacion	
Numri i shteteve që kanë abstenuar	3
Numri korrespondues i votave	63 650
Përqindja e totalit të votave (kapitalit të përgjithshëm të regjistruar)	1,165%

SHTETET	Vota	Pjesëmarrja	PO	JO	Abstenim
Shqipëria	13 385	y	y		
Belgjika	164 321	y	y		
Bosnja dhe Hercegovina	9 689	y			y
Bullgaria	62 459	n			
Kroacia	21 376	y	y		
Qipro	19 882	y		y	
Republika Çeke	43 037	y	y		
Danimarka	89 667	y	y		
Estonia	12 723	y	y		
Finlanda	69 786	y	y		
Franca	915 770	y	y		
Gjeorgjia	9 876	y		y	
Gjermania	915 770	y	y		
Greqia	164 321	y	y		
Selia e Shenjtë	137	y			y
Hungaria	44 788	y	y		
Islanda	10 144	y	y		
Irlanda	48310	y	y		
Italia	915 770	y	y		
Latvia	12 808	y	y		
Lihtenshtajni	2 921	y	y		
Lituania	12 588	y	y		
Luksemburgu	34 734	y	y		
Malta	10 144	y	y		
Moldavia	5 488	y		y	
Mali i Zi	6 584	y	y		
Holanda	198 813	y	y		
Norvegjia	69 786	y	y		
Polonia	128 260	y	y		
Portugalia	139 172	y	y		
Rumunia	59 914	y	y		
San Marino	4 867	y	y		
Serbia	25 814	y		y	
Slllovakia	18 959	y	y		
Slllovenia	12 295	y	y		
Spanja	597 257	y		y	
Suedia	139 172	y	y		
Zvicra	53 824	y			y
“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”	12 723	y	y		
Turqia	388 660	y	y		
TOTALI	5 465 660	39	31	5	3